

**VENDIM**

Nr. 276, datë 6.4.2020

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS ME  
OBJEKT “BLERJE MATERIALE  
MJEKËSORE NË KUADËR TË MASAVE  
PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES  
SË VIRUSIT COVID-19”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e kontratës me objekt “Blerje materiale mjekësore në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19”, me palë Ministrinë e Drejtësisë dhe operatorin ekonomik “FEDOS”, sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**



**VENDIM**  
**Nr. 272, datë 3.4.2020**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR  
LOTIN 1 ME OBJEKT “BLERJE KITE  
PËR LABORATORIN MIKROBIOLOGJIK  
PËR REALIZIMIN E RT-PCR TË  
PËRSHTATSHËM PËR T’U PËRDORUR  
PËR PAJISJEN E EXISTATION TË  
FIRMËS BIONEER OSE EKVIVALENT”  
PËR QSUT-NË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e kontratës për lotin 1 me objekt “Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për t’u përdorur për pajisjen e Existation të firmës Bioneer ose ekuivalent” për QSUT-në, me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik “O.E.S DISTRIMED”, sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë me objekt “Blerje kite dhe reagentë, evadim mbetje antiCOVID-19 ndarë në dy lote”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**



**VENDIM**  
**Nr. 273, datë 3.4.2020**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR  
LOTIN 2 ME OBJEKT“TRAJTIM DHE  
ASGJËSIM TË MBETJEVE QË DALIN  
NGA SHËRBIMET KU MARRIN  
TRAJTIM PACIENTËT ME COVID-19  
PËR QSUT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e kontratës për lotin 2 me objekt “Trajtim dhe asgjësim të mbetjeve që dalin nga shërbimet ku marrin trajtim pacientët me COVID-19 për QSUT”, me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik “ECO RIKIKLIM”, sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë me objekt “Blerje kite dhe reagentë, evadim mbetje antiCOVID-19 ndarë në dy lote”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr.274, datë 3.4.2020**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS ME OBJEKT “FURNIZIM VENDOSJE  
RESPIRATORË ME DY MODALITETE PËR ADULTË DHE MOSHË  
PEDIATRIKE PËR COVID-19”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 1, të kreut VII, të vendimit nr.203, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e kontratës me objekt “Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19”, me palë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe operatorin ekonomik “TBS 96”, sh.p.k., të zhvilluar me procedurën e drejtpërdrejtë të prokurimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**